



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:280328
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05500591

C.nr.1940/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses N.R., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar V.Rr., me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 854.95 euro, jashtë seance me datë 25 .03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses N.R., nga Gjakova, përmes së cilës ka kërkuar që të “*APROVOHET kërkesëpadia e paditëses si e bazuar dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës-Drejtoria e Arsimit që paditëses së lartcekur në emër të kompensimit të përqindjes së inflacionit për: 1.1.1 periudhën Janar-Dhjetor 2018, për 1.1% x 421.00 (paga bazë)=4.63x12 muaj = 55.57 €; 1.1.2 periudhën Janar-Dhjetor 2019, për 2.7% x 421.00 (paga bazë)=11.36 x 12 muaj = 136.32 €; 1.1.3 periudhën Janar-Dhjetor 2020, për 0.2% x 421.00 (paga bazë)=084 x 12 muaj =10.10 €; 1.1.4 periudhën Janar-Dhjetor 2021, për 3.4% x 421.00 (paga bazë)=14.31 x 12 muaj = 171.76 € dhe 1.1.5 periudhën Janar-Shtator 2022, për 12.7% x 421.00 (paga bazë)=53.46 x 9 muaj = 481.20 € si dhe shpenzimet e procedurës.*”

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja N.R., nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 19.12.2022, përmes të autorizuarve të saj Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja është punëtore e arsimit në shkollën “... në fshatin ... Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për

çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditëses. Në padi ka kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që në emër të kompensimit të diferencës së inflacionit në pagë nga data 01.01.2018 deri me datë 30.09.2022 paditëses të ia paguajë shumën prej 854.95 euro, e ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj V.Rr., në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 28.09.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se ky kompensim paditëses nuk i takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka konsideruar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi që Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Tutje ka shtuar se paditëses nuk i takon e drejta e kompensimit të inflacionit pasi që në rast të shfaqjes së tij nuk godet vetëm një sektor të punësuarve si në rastin konkret sektorin e arsimit, por e godet tërë aparatit shtetëror. Ka konsideruar se në rastin konkret ka po ashtu parashkrim të kërkesës në të holla, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazë dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “....” në fshatin, komuna e Gjakovës, si mësimdhënëse e mësimit klasor, mirëpo të njëjtës i është ndërprerë kontrata e punës me datën 31.10.2018 për shkak të daljes në pension, fakt ky i vërtetuar nga Vendimi me nr. 118/02-25619, të datës 11.09.2018, i lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që pretendimet e të autorizuarës të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, i morri si të bazuara vetëm sa i përket periudhës prej 01.01.2018 deri me 31.10.2018, pasi që sipas provave të administruara vërtetohet se paditësja kërkesën e saj për kompensimin e përqindjes së inflacionit e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ashtu që në rastin konkret padia është parashtruar me datë 19.12.2022 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit nga marrëdhënia e punës.

Ndërsa pjesa tjetër e refuzuar, i referohet kërkesës së paditëses që t'i kompensohet pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit edhe për periudhën prej 31.10.2018 deri me 30.09.2022, për faktin se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga vendimi i të paditurës Komuna e Gjakovës, me nr. 118/02-25619 i datës 11.09.2018, rezulton se paditëses i është ndërprerë kontrata nga marrëdhënia e punës me datën 31.10.2018, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit pra moshën 65 vjeçare, për çka gjykata nuk ia njohi këtë kompensim paditëses për periudhën e lartcekur.

Për arsyet e cekura si më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës së përcaktuar me nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi ti arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi apo po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësja, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

-Departamenti i Përgjithshëm-
C.nr.1940/22, datë 25.03.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.